Fjala përshëndetëse nga z. ***Erik BERGLOF****, Drejtor, LSE Instituti për Çështje Globale*

Përshëndetje,

Së pari, dëshiroj të them se rikthehem në Tiranë me shumë kënaqësi dhe jam shumë i gëzuar të shoh miq të vjetër e të njihem me persona të rinj të talentuar në Shqipëri.

Në eksperiencën time të mëparshme, kur punoja me BERZH-in, zyra ime bashkëpunonte me mbi 30 shtete. Unë duhej të zgjidhja se ku do të fokusohesha dhe, pas vitit 2013, unë zgjodha të përqendrohesha te Shqipëria. Arsyeja që më shtyu për këtë zgjedhje është se pashë një angazhim të mirëfilltë për reforma nga ekipi i qeverisë së drejtuar nga Kryeministri Edi Rama, i cili pritej të merrte detyrën, përfshirë në këtë ekip edhe Ministrin aktual të Financave dhe Ekonomisë, z. Arben Ahmetaj. Kishte një dëshirë të vërtetë për t'i realizuar gjërat. Sigurisht ishte edhe perspektiva e arritjes së statusit të vendit kandidat dhe eventualisht e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Rrethanat u ndërthurën në mënyrë të favorshme për Shqipërinë, në mënyrë që vendi të ecte përpara, duke shënuar progres pas një periudhe shumë të vështirë.

Krahasuar me atë kohë, situata sot është shumë e ndryshme. Atëherë, kishte zhbalancime masive makroekonomike, gropa të mëdha fiskale, sistem ineficient pagesash, korrupsion, etj. Sot, Shqipëria është një vend shumë i ndryshuar. Ajo është shndërruar në një model për mënyrën se si të arrihet stabilizimi makroekonomik, si të zbatohen reformat strukturore. E gjitha kjo është dëshmi e punës së Kryeministrit dhe ekipit të tij.

Tashmë, i jam rikthyer botës akademike dhe jam i kënaqur që jam pjesë e *London School of Economics and Political Science* (LSE). Mua m'u caktua detyra për ndërtimin nga fillimi të Institutit për Çështje Globale të LSE-së dhe Laboratorit të tij për Politika Globale. Misioni ynë është që të trajtojmë çështje globale duke nxitur zgjidhje që i kanë rrënjët në mjedisin vendas. Këto zgjidhje mund të gjenden vetëm nëpërmjet partneritetit me institucionet vendase. Dhe, në këtë frymë, kemi nisur partneritetin me Bankën e Shqipërisë.

Pronësia vendore e reformave është tejet e rëndësishme për suksesin e tyre. Gjatë vitit të kaluar, kam qenë i përfshirë në një grup ndërkombëtar të G20, i ashtuquajturi Grupi i Personave të Shquar i G20. Ky Grup u ngrit për të shqyrtuar sistemin e institucioneve financiare ndërkombëtare me qëllim trajtimin e sfidave globale. Në themel të propozimit të paraqitur nga Grupi është pronësia vendase. Për këtë arsye, një institucion i tillë si Banka e Shqipërisë është shumë i rëndësishëm. Personeli i saj është kompetent dhe ka shumë përvojë - ndër vite ky institucion ka ndërtuar dhe ka forcuar besimin në të dhe ka vendosur pavarësinë e tij. Për rrjedhojë, Banka e Shqipërisë mund të ndihmojë për arritjen e objektivit të qeverisë në lidhje me gjenerimin e një rritjeje ekonomike përfshirëse dhe me stabilizimin e sistemit financiar. Banka e Shqipërisë dhe LSE-ja po organizojmë këtë konferencë së bashku dhe ne mbetemi të gatshëm për realizimin e shumë bashkëpunimeve të tjera në të ardhmen. Guvernatori Sejko është për t'u marrë shembull për mënyrën sesi ka drejtuar politikën monetare dhe është kënaqësi e madhe për ne që të punojmë bashkë me ekipin e tij.

Një nga sfidat kryesore që shohim në nivel global është qëndrueshmëria financiare ndaj goditjeve. Ne e kemi përmirësuar shëndetin e sektorit financiar; nga ana tjetër, kemi parë edhe rritje masive të borxhit, në veçanti në vendet në zhvillim. Duke parë zhvillimet e Shqipërisë, krahasuar me gjashtë apo shtatë vjet më parë, kur unë u angazhova për herë të parë me këtë vend, vërej se arritjet janë mbresëlënëse. Përsëri, merita i takon bankës qendrore, Bankës së Shqipërisë.

Doja të falënderoja të gjithë ata që janë përfshirë në organizimin e kësaj konference – për të cilën duhet të them se ka qenë vërtetë një punë në ekip. Nga ana e Bankës së Shqipërisë, do të veçoja Donald Duraj, Altin Tanku dhe Enri Herri. Ata kanë punuar me ekipin tonë: Mario Blejer dhe Piroska Nagy-Mohacsi. Falënderime të veçanta për të gjithë ata që kanë mundësuar realizimin e gjithçkaje në këtë konferencë.

Doja të theksoja, gjithashtu, se kjo nuk është konferencë e parë që organizon Banka e Shqipërisë. Ajo ka organizuar konferenca të tilla për shumë vjet. Ne ndërtojmë mbi themelet e një tradite të konsoliduar tashmë dhe kam kënaqësinë të shoh të pranishëm edhe partnerin e mëparshëm të BSH-së nga SEESOX dhe PEFM nga Universiteti i Oxford-it, dhe drejtuesin e ri të tij, z. Charles Enoch. Natyrisht që dëshirojmë të ndërtojmë më tej mbi themelet që tashmë janë hedhur nga këto

bashkëpunime.

Ju falënderoj edhe njëherë dhe uroj sukses në punimet e kësaj konference.

Faleminderit!